



Datë: 31.03.2026  
Numër Protokollit: 1608/2026

A.nr.85/2026

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave** i përbërë nga: Eshref Shabani-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Malsore Gashi Bajraktari-anëtare, me Ilire Mehmeti-Shaqiri, në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.85/2026 të datës 27.01.2026 të parashtruar nga ankuesja H.M-A, kundër organit të punësimit/Agjencia e Kosovës për Forenzik, në çështjen juridike “*Kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.4 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 31.03.2026, mori këtë:

## V E N D I M

**I. Aprovohet si e bazuar** ankesa me numër A.nr.85/2026 e datës 27.01.2026, e parashtruar nga ankuesja H.M-A, **anulohet** Përgjigja e datës 05.01.2026 e Udhëheqësit të Divizionit për Financa dhe SHP.

**II. Detyrohet** Kryeshefi Ekzekutiv në Agjencinë e Kosovës për Forenzik, që të bëjë shqyrtimin e kërkesës së datës 17.12.2025, të parashtruar nga ankuesja e lartshënuar, dhe të nxjerr aktin administrativ në pajtim me legjislacionin në fuqi, brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.

**III.** Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

## A r s y e t i m

Nëpunësja civile, H.M-A (*tutje referuar ankuesja*), më datë 27.01.2026, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër përgjigjes nën shenjë AKF/2026-001 të datës 05.01.2026 të Udhëheqësit të Divizionit të Financave dhe SHP.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*tutje referuar Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 02.02.2026, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Agjencia e Kosovës për Forenzik, ndërsa, kjo e fundit më datë 13.01.2026, ka dorëzuar shkresat lidhur me çështjen në procedurë.

***Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave tutje referuar Kolegji i Këshillit, ka administruar këto prova:*** Ankesën me numër protokolli 415/2026 të datës 27.01.2026 të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër AKF/2019-166; Kërkesën e datës 10.01.2023; Ankesën e datës 08.02.2023; Vendimin me numër AKF/2023 të datës 22.03.2023; Ankesën e datës 05.11.2025; Vendimin e datës 26.11.2025 të KPMSHCK-se; Kërkesën e datës 17.12.2025; Përgjigjen e datës 02.01.2026; Përgjigjen në ankesë të datës 06.02.2026; Listën e pagave për vitin 2024-2025;

Kolegji i Këshillit, pasi që ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës, ka konstatuar se meqenëse nuk është nxjerr akt administrativ nga personi kompetent të cilit ankuesja edhe i është drejtuar me kërkesë, atëherë ekziston baza ligjore që të detyrohet Kryeshefi Ekzekutiv në Agjencinë e Kosovës për Forenzik, të nxjerr aktin administrativ në pajtim me legjislacionin në fuqi lidhur me shqyrtimin e kërkesës të datës 17.12.2025, parashtruar nga ankuesja, ***sepse:***

Nga administrimi i provave materiale të lëndës rrjedhë se ankuesja sipas vendimit të datës 06.06.2011 mbanë pozitën e punës Analist i Lartë pranë njësisë për pranimin dhe dorëzimin dhe analizës së dëshmive ndërsa, sipas vendimit me Nr. Protokolli AKF/2019-166 të datës 18.07.2019, të Kryeshefit Ekzekutiv në Agjencinë e Kosovës për Forenzik, ankuesja ka marr gradën shkencore Specialist.

Tutje, me date 17.12.2025 ankuesja përmes kërkesës nën shenjen AKD/2025-119 drejtuar Kryeshefit Ekzekutiv në Agjencinë e Kosovës për Forenzik ka kërkuar që i lëshohet vendimi si Ekspert i Forenzikës fusha e Teknologjisë Informative Forenzike pasi që e njëjta e mbanë këtë pozitë por vendimi ende nuk i është lëshuar dhe është e diskriminuar sepse i gjithë stafi i cili është graduar me gradën Specialist në Agjencinë e Forenzikes e kanë vendimin e Ekspertit Forenzike përveç ankueses, edhe pse e njëjta është graduar me gradën Specialist duke i ndjekur të gjitha rregullat brenda AKF-se. Ndërsa Udhëheqësi i Divizionit për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme përmes përgjigjes nën shenjen AKF/2026-001 të datës 05.1.2026 i është përgjigjur ankueses se citoj; Për arsyeje se çështja në fjalë ndërlihet drejtpërdrejtë me rregullimin ligjor të statusit, gradimit dhe certifikimit, të, cilat rregullohen me legjislacionin e veçante, për me tepër, duke qene se AKF aktualisht nuk disponon një përgjigje apo qëndrim zyrtar nga Ministria e Punëve të Brendshme lidhur me vlefshmërinë juridike të akteve nënligjore të AKF-se që rregullojnë gradimin dhe çështje të ndërlidhura, nuk ekziston bazë e qartë ligjore për procedim të mëtejshëm administrativ.

Ankuesja, në ankesën e parashtruar në Këshill, kërkon nga këshilli që në mënyrë meritore ta shqyrtoj ankesën e ankueses duke e obliguar organin e punësimit që ankueses ti lëshoj vendimin për Ekspert i Forenzikes -fusha e Teknologjisë Informative Forenzikes, pasi që ankuesja është diskriminuar sepse e vetmja nga koleget e saj nuk është pajisur me këtë vendim.

Në kuptim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankueses dhe konstatimit të ligjshmërisë së aktit të kontestuar nga ankuesja, Kolegji i Këshillit ka analizuar dispozitat ligjore respektivisht nenin 52, paragrafi 1, nen paragrafi,1.3,1.4,1.5, dhe 1.7, të Ligjit Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se; 1. Një akt administrativ është i paligjshëm nëse:1.1. është nxjerre në mungesë të autorizimit nga një ligj, sipas paragrafit 2 të nenit 4 të këtij Ligji; 1.2. organi publik që e nxjerr ka vepruar pa pasur kompetencë;1.3. është rezultat i shkeljes të dispozitave lidhur me procedurën administrative 1.4. është nxjerre në kundërshtim me dispozitat që rregullojnë formën apo elementet e detyrueshme të aktit administrativ; 1.5. është në kundërshtim me ligjin material.

Kolegji i Këshillit, duke u bazuar në kuadrin ligjor të cekur si më lartë, lidhur me obligimin e organit përkatës për të vendosur lidhur me kërkesën e palës, e obligon Kryeshefin Ekzekutiv në Agjencinë e Kosovës për Forenzik, që të nxjerr aktin administrativ në pajtim me legjislacionin në fuqi lidhur me shqyrtimin e kërkesës të parashtruara nga pala ankuese të përfshira në këtë vendim, në atë mënyrë që gjatë shqyrtimit të kërkesës të shqyrtohen të gjitha pretendimet e palës ankueses dhe të vendoset për të gjitha pretendimet në fjalë në kuptim të nenit 48 paragrafi 1 ndërlidhur me nenin 134 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 dhe 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

***Këshillë juridike:** Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**LËNDA, A.NR.85/2026**

**Ilire Mehmeti-Shaqiri**

\_\_\_\_\_  
**Procesmbajtëse**

**Eshref Shabani**

\_\_\_\_\_  
**Kryetar i Kolegjit**

**Vendimi i dërgohet:**

- Ankueses H.M-A;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Agjencinë e Kosovës për Forenzik; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.